



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 11434 Prot.

Tiranë, më 01 . 11 . 2018

URDHËR

NR. 731 , DATË 01 . 11 . 2018

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZHVILLIMIN E OLIMPIADAVE  
KOMBËTARE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, dt.10.12.2010 “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 26.04.2017, si edhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.02.2013 “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

MINISTËR

Lindita Nikolla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Artikulli 1

OBJEKTIVAT E PËRQYRTIRËSIAVE

Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe procedurën e organizimit të olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar, të cilat zhvillohen në tërësi në shkollat e arsimit të mesëm dhe në shkollat e arsimit të lartë të nivelit të parë dhe të dytë të arsimit të mesëm.

Artikulli 2

DEKLARIMET

Kjo rregullore, miratohet dhe miratohet në përputhje me ligjet dhe aktet ligjorë të Republikës së Shqipërisë, veçanësisht Ligjin për Sportin dhe Ligjin për Ligjin për Organizimin dhe Zhvillimin e Olimpiadave Kombëtare në Arsimin Parauniversitar.

**RREGULLORE**

**PËR**

**ZHVILLIMIN E OLIMPIADAVE KOMBËTARE NË ARSIMIN**

**PARAUNIVERSITAR**

Artikulli 3

DETYTET E MARRËDHTYSHËSIAVE TË VLERËSËSIAVE  
DHE TË KRYEQËNDRUESIT

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar, të cilat zhvillohen në tërësi në shkollat e arsimit të mesëm dhe në shkollat e arsimit të lartë të nivelit të parë dhe të dytë të arsimit të mesëm.

Artikulli 4

ORGANIZIMI I OLIMPIADAVE KOMBËTARE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Organizimi i olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar bëhet në përputhje me ligjet dhe aktet ligjorë të Republikës së Shqipërisë, veçanësisht Ligjin për Sportin dhe Ligjin për Organizimin dhe Zhvillimin e Olimpiadave Kombëtare në Arsimin Parauniversitar.

Artikulli 5

## Neni 1

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kjo Rregullore përcakton rregullat për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar, si dhe përcakton institucionet shtetërore dhe strukturat arsimore përgjegjëse dhe bashkëpunuese për realizimin e këtij procesi.

## Neni 2

### PËRKUFIZIME

Në këtë Rregullore, shkurtimet dhe përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) MASR është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- b) QSHA është Qendra e Shërbimeve Arsimore.
- c) Shkollë është institucioni që ofron shërbim arsimor për arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.
- d) Shkollë 9-vjeçare është shkollë e arsimit bazë, publike dhe/ose private.
- e) Gjimnazi është shkollë e mesme e përgjithshme, publike dhe/ose private.
- f) "PA" është përgjegjësi i administrimit të qendrës së zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- g) "AM" është administratori i mjedisit të zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- h) "AS" është administratori i sekretimit të testeve të olimpiadave kombëtare.

## Neni 3

### DETYRAT E MASR, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Olimpiadat organizohen, drejtohen dhe menaxhohen nga MASR, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

## Neni 4

### VENDI QË ZENË OLIMPIADAT NË AKTIVITETIN SHKOLLOR

Olimpiadat janë veprimtari të cilat kanë për qëllim të nxisin punën me nxënësit dhe të nxjerrin në pah prirjet dhe talentin e tyre në lëndë të veçanta. Në këto veprimtari marrin pjesë të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar të shkollave publike dhe/ose private që plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore dhe në këtë Rregullore.

## Neni 5

## LËNDËT NË TË CILAT ZHVILLOHEN OLIMPIADAT

Olimpiadat zhvillohen në Arsimin bazë dhe në Arsimin e mesëm të lartë:

1. Në Arsimin bazë zhvillohet olimpiada e lëndës "Matematikë" për klasën e 9-të.
2. Në arsimin e mesëm të lartë zhvillohen olimpiadat për lëndët: Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Informatikë, Gjuhë Letërsi, Histori dhe Gjeografi.

### Neni 6

#### PROCEDURA E ZHVILLIMIT TË OLIMPIADAVE KOMBËTARE

Olimpiadat kombëtare zhvillohen në tri faza: në nivel shkolle, në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe në nivel kombëtar, sipas udhëzuesit vjetor të miratuar nga MASR.

**I. Faza e parë** zhvillohet në nivel shkolle. Në fazën e parë marrin pjesë nxënës të cilët e kanë të paktën 8-të notën vjetore të klasës paraardhëse në lëndën ku do të marrin pjesë në olimpiadë. Kjo fazë zhvillohet sipas këtyre procedurave:

- a) Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar hartojnë testet e olimpiadave. Në çdo shkollë ngrihen komisionet për administrimin dhe vlerësimin e testeve. Këto komisione miratohen paraprakisht nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
- b) Data dhe ora e zhvillimit të olimpiadës afishohet në çdo shkollë, jo më vonë se një javë përpara zhvillimit të saj.
- c) Olimpiadat zhvillohen sipas udhëzuesit vjetor të zhvillimit të olimpiadave kombëtare për atë vit shkollor, i cili miratohet nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- d) Olimpiadat zgjasin tri orë. Çelësi i zgjidhjes publikohet dy orë pas mbarimit të testimit, në ambientet e shkollave në të cilat zhvillohen olimpiadat dhe në faqen elektronike të shkollës dhe të institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
- e) Anëtarët e komisionit të hartimit dhe vlerësimit të testeve, fillimisht duhet të deklarojnë me shkrim që nuk kanë konflikt interesi.
- f) Rezultatet e vlerësimeve, brenda 7 ditëve u bëhen të njohura nxënësve pjesëmarrës dhe dërgohen në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, krahas rezultateve të vlerësimeve, dërgohen edhe punimet (testet) e tri vendeve të para.
- g) Testet dhe vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve, si dhe çdo dokument që lidhet me zhvillimin e olimpiadës janë objekt inspektimi i institucionit përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe ruhen 6 (gjashtë) muaj në shkollë.

**II. Faza e dytë** zhvillohet në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, me nxënësit fitues, që në fazën e parë kanë marrë jo më pak se 70% të pikëve. Kjo fazë zhvillohet sipas këtyre procedurave:

- a) Testet hartohen nga QSHA.
- b) Testet dërgohen me postë një ditë përpara zhvillimit të olimpiadës në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.
- c) Olimpiadat zhvillohen sipas udhëzuesit vjetor të hartuar nga MASR, zgjatin tri orë dhe fillojnë në orën 10:00.
- d) Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, cakton mjediset ku do të zhvillohet olimpiada dhe njofton nxënësit pjesëmarrës.
- e) Në çdo mjedis caktohet një Përgjegjës Administrimi (PA) dhe Administratorë të mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare, të miratuar nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës.
- f) Përgjegjësi i Administrimit (PA) fillon identifikimin e nxënësve pjesëmarrës në olimpiadë, sipas listës së ardhur nga institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, një orë përpara fillimit të saj.
- g) Përgjegjësi i Administrimit (PA) u shpërndan me procesverbal administratorëve të mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare, testet për nxënësit.
- h) PA dhe AM nuk lejojnë hyrjen e personave të paautorizuar në mjedisin ku zhvillohet olimpiada.
- i) PA organizon ndarjen e administratorëve në mjediset ku do të zhvillohet olimpiada.
- j) PA dhe AM të olimpiadave duhet të mos jenë mësues në shkollën e nxënësve fitues, si edhe të lëndës në të cilën zhvillohet olimpiada.
- k) Për çdo 15-20 nxënës duhet caktuar një administrator i mjedisit të zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- l) PA-të, AM-të, AS-të dhe nxënësit ndalohej të mbajnë celular gjatë zhvillimit të olimpiadës.
- m) Monitorimi i olimpiadave në këtë fazë kryhet nga institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.
- n) Zarfi me testet e olimpiadës hapet në kohën e fillimit të olimpiadës nga PA dhe AP, në prani të nxënësve.
- o) Për kryerjen e procesit të sekretimit të testeve, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar cakton administratorët e sekretimit (AS), të cilët janë trajnuar për procesin.
- p) Sekretimi fillon pasi të ketë përfunduar shpërndarja e testeve.
- q) Testi dhe çelësi i zgjidhjes publikohen në faqen e internetit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
- r) Komisionet e vlerësimit të testeve ngrihen me vendim të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe kanë në përbërje të tyre specialistë të tyre, si edhe mësues të lëndës/ve me kualifikimin më të lartë.
- s) Nxënësit që janë vlerësuar me mbi 70% të pikëve të mundshme, fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në fazën e tretë të olimpiadës që zhvillohet në nivel kombëtar.
- t) Komisioni i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, klasifikon nxënësit fitues në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe ua komunikon shkollave.
- u) Anëtarët e komisionit të vlerësimit të testeve, fillimisht duhet të deklarojnë me shkrim që nuk kanë konflikt interesi. Këto deklarata ruhen për një vit në

institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

- v) Rezultatet e përgjigjeve u bëhen të njohura nxënësve pjesëmarrës brenda 7 ditëve nga zhvillimi i olimpiadës dhe depozitohen në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.
- w) Testet dhe vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve janë objekt inspektimi i institucionit përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe ruhen një vit në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.
- x) Pas përfundimit të fazës së dytë, si dhe afatit të ankimit, sipas procedurës së parashikuar në nenin 9, rezultatet e nxënësve fitues dërgohen zyrtarisht nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar në MASR dhe QSHA, 15 ditë para fillimit të fazës së tretë të olimpiadës për lëndët përkatëse.
- y) Lista e nxënësve fitues të vendit të parë, të dytë dhe të tretë bashkë me testet e tyre dërgohen në QSHA.

**III. Faza e tretë** zhvillohet në nivel kombëtar dhe marrin pjesë nxënësit që në fazën e dytë janë vlerësuar me mbi 70% të pikëve. Kjo fazë zhvillohet në Tiranë, sipas procedurave të mëposhtme:

- a) Hartimi dhe vlerësimi i testeve të olimpiadës/ve për nxënësit e arsimit 9-vjecar dhe të mesëm, bëhet nga QSHA.
- b) Në fazën e tretë, testi i olimpiadës, për secilën lëndë, për arsimin e mesëm të lartë është i njëjtë për nxënësit e të gjitha klasave.
- c) Testi dhe çelësi i zgjidhjes publikohen në faqen e QSHA-së, MASR-së, dy orë pas përfundimit të olimpiadës përkatëse.
- d) Testet sekretohen me barkod nga punonjësit e QSHA-së.
- e) Punonjësit e QSHA-së e monitorojnë procesin dhe në përfundim marrin në dorëzim nga PA materialet e testimit dhe i dorëzojnë ato në institucion, jo më vonë se tre orë nga orari i përfundimit të olimpiadës.
- f) Në varësi të numrit të nxënësve që do të marrin pjesë në këtë fazë, QSHA, cakton qendrat ku do të zhvillohet olimpiada.
- g) Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar cakton Përgjegjësit e Administrimit (PA) dhe Administratorët e Mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- h) Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, i dërgon zyrtarisht QSHA-së listën e PA-ve dhe AM-ve, 3 (tre) ditë përpara datës së zhvillimit të olimpiadës, për secilën lëndë.
- i) PA kryen identifikimin e nxënësve pjesëmarrës në olimpiadë, sipas listës së ardhur nga QSHA, një orë përpara fillimit të saj.
- j) PA u shpërndan me procesverbal Administratorëve të Mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare, testet për nxënësit pjesëmarrës.
- k) PA dhe AM nuk lejon hyrjen e personave të paautorizuar në mjedisin ku zhvillohet olimpiada.
- l) PA organizon ndarjen e administratorëve në mjediset ku do të zhvillohet olimpiada.

- m) PA dhe Administratorët e Mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare duhet të mos jenë mësues të shkollës së nxënësve fitues, si edhe të lëndës në të cilën zhvillohet olimpiada.
- n) Për çdo 15-20 nxënës duhet caktuar një Administrator i Mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- o) PA, Administratorët e Mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare dhe nxënësit nuk lejohet të mbajnë celular gjatë zhvillimit të olimpiadës.
- p) Testet dhe vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve janë objekt inspektimi i institucionit përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe ruhen një vit në QSHA.

#### Neni 7

### KRITERET DHE PROCEDURA E SHPALLJES SË FITUESVE TË FAZËS SË TRETË

Institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore shpall fituesit e olimpiadës, sipas këtyre kriterëve:

- a) Fitues i vendit të parë, vlerësohet nxënësi që ka fituar 80% deri në 100% të pikëve totale të testit.
- b) Fitues i vendit të dytë, vlerësohet nxënësi që ka fituar nga 70% deri në 79% të pikëve totale të testit.
- c) Fitues i vendit të tretë vlerësohet nxënësi që ka fituar nga 60% deri në 69% të pikëve totale të testit.
- d) Shpallja e fituesve bëhet jo më vonë se 7 ditë nga dita e zhvillimit të olimpiadës.
- e) QSHA dërgon në MASR, procesverbalin me emrat e nxënësve fitues, si dhe renditjen e tyre sipas barkodeve.
- f) Përputhja e barkodeve me emrat e nxënësve bëhet në QSHA, në prani të përfaqësuesit të MASR.
- g) Emrat e fituesve të olimpiadave kombëtare, publikohen në faqen e websitet-it të QSHA-së dhe MASR-së.

#### Neni 8

### PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË NXËNËSVE NË OLIMPIADAT NDËRKOMBETARE

Për përzgjedhjen e nxënësve që do të marrin pjesë në olimpiadat ndërkombëtare, ndiqet procedura e mëposhtme:

- a) Me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë ngrihet një komision për organizimin e procedurave të përzgjedhjes së nxënësve që do të marrin pjesë në olimpiadat ndërkombëtare për shkollat e arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. Në komision marrin pjesë specialistë të lëndëve nga QSHA dhe pedagogë të propozuar nga IAL-të.

- b) Në procedurat e përzgjedhjes së nxënësve për olimpiadat ndërkombëtare për shkollat AMU dhe AML, marrin pjesë nxënësit fitues në të tri fazat e olimpiadave kombëtare në lëndët përkatëse.
- c) Komisioni është përgjegjës për hartimin e testit të përzgjedhur, vlerësimin përfundimtar dhe përzgjedhjen e nxënësve që do të marrin pjesë në olimpiadat ndërkombëtare.
- d) Data e zhvillimit të testimit përzgjedhës shpallet në faqen elektronike të MASR-së, QSHA-së dhe njoftohen institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar .
- e) Mjedisi ku zhvillohet ky testim përcaktohet nga MASR.
- f) Administrimi i testimit përzgjedhës bëhet nga MASR dhe QSHA.
- g) Shpallja paraprake e fituesve bëhet e njohur në faqen elektronike të QSHA-së dhe MASR-së.
- h) Shpallja përfundimtare e fituesve publikohet në faqen elektronike të QSHA-së dhe MASR-së, menjëherë pas përfundimit të afateve të ankimit dhe vendimeve të komisionit të MASR, të ngritur sipas nenit 9, shkronja “h” të kësaj rregulloreje.
- i) Anëtarët e Komisionit si dhe gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në proces duhet të deklarojnë që nuk kanë konflikt interesi.
- j) Në rastet kur nuk ka fitues, sipas procedurave të përcaktuara në këtë urdhër, atëherë nuk mund të ketë pjesëmarrje në olimpiadën respektive ndërkombëtare.
- k) MASR merr përsipër financimin e ekipit pjesëmarrës në olimpiadat ndërkombëtare, në përputhje me buxhetin e hartuar dhe miratuar për këtë veprimtari të arsimit parauniversitar.
- l) Pjesëmarrja në këto aktivitete miratohet me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

## Neni 9

### PROCEDURA E ANKIMIT TË NXËNËSVE

Nxënësi ka të drejtë të bëjë ankim duke ndjekur këto hapa:

- a) Kërkesat për rivlerësim të testit për të 3 (tre) fazat kryhen brenda 3 (tre ditëve) pas shpalljes së rezultateve.
- b) Për fazën e parë kërkesat për rivlerësim të testit depozitohen në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.
- c) Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, krijon një komision të posaçëm i cili shqyrton kërkesën e nxënësit dhe kthen përgjigje me shkrim brenda 5 ditëve. Bashkë me përgjigjen, nxënësit i dorëzohet fotokopja e përgjigjes së testit.
- d) Për fazën e dytë, kërkesat për rivlerësim të testit depozitohen në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.
- e) Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar grumbullon ankimet dhe i përcjell ato bashkë me teste në QSHA.
- f) Për fazën e dytë ankimet shqyrtohen nga QSHA.

- g) QSHA krijon një komision të posaçëm i cili shqyrton kërkesat e nxënësve dhe i dërgon zyrtarisht brenda 5 ditëve në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, vendimet përkatëse.
- h) Për të shqyrtuar ankesën/at e nxënësve të fazës së tretë, si dhe të fazës së përzgjedhjes për olimpiadat ndërkombëtare, MASR ngre një komision të përbërë nga specialistë të QSHA-së, mësues të lëndëve përkatëse dhe pedagogë të propozuar nga IAL-të.
- i) Komisioni shqyrton ankesën/at dhe vendimin përfundimtar, të firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit e përcjell në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë të MASR-së dhe në QSHA.

#### **Neni 10**

#### **PROMOVIMI DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR I NXËNËSVE QË SHPALLEN FITUES TË OLIMPIADAVE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE**

- a) Nxënësit fitues të olimpiadave të fazës së parë, drejtoritë e shkollave përkatëse i pajisin me certifikata për vendin e fituar në nivel shkolle.
- b) Nxënësit fitues të olimpiadave të fazës së dytë, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave përkatëse, i pajisin me certifikata për vendin e fituar.
- c) Nxënësit fitues në olimpiadat kombëtare, faza e tretë (vendi i parë, i dytë, i tretë), dhe ndërkombëtare, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i pajis me certifikata për vendin e fituar.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet duke filluar nga viti shkollor 2018-2019.